



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL DIBER**

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E  
THJESHTUAR – MALLRA”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Oksigjen Mjekësor për nevoja të Spitalit Rajonal Dibër per nje periudhe mbulimi  
12 muaj”**

**REF-15493-08-06-2024**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Oksigjen – 24111900-4.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**2,270,100 (dy milion e dyqind e shtatedhjet mije e njeqind) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

#### Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:b) gjendjen ekonomike dhe financiare;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:  
c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.

**Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Kapaciteti Teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

**Njësia përcaktoi kritere për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregtim me shumice të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese. Te plotësohet ne Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve të DST.

**Argumentimi:**

Ky kriter është vendosur ne perputhje **piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik"**, ne te cilen është e percaktuar se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi..*

Ky kriter është vendosur ne perputhje me **piken 2 dhe piken 8 te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"**, ku percaktohet se:

*2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Kjo kërkesë vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është ne përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", dhe këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

#### **2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/
- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

- 2.3.5** Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregëtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

- 2.3.6** Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ perputhet me objektin e Prokurimit

- 2.3.7** Certifikate OHSAS 18001:2007, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë . Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 2.3.8** Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjeksore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

### **Argumentimi:**

Kërkesa për pikat e mësipërme (2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8) është përcaktuar bazuar në:

Nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Nenin 44 pika 1 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:

*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka në dispozicion 100 bombola oksigjeni në pronësi ose me qera. Për të vërtetuar këto kriter, OE duhet të paraqesë një dëshmi për pronësinë e kësaj sasi bombolash (fatura blerje ose dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit). Gjithashtu bombolat që do të furnizohen prej tij, duhet të plotësojnë kushtet teknike të pajisjeve nën presion. Për këto duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, të vlefshëm për vitin 2024, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë ose duhet të paraqesë certifikate konformiteti nga vendi i origjinës ose nga një trup inspektues që bombulat plotësojnë kushtet konform legjislacionit në fuqi.

### **Argumentimi:**

Keto kritere vendosen në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin

me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

### **2.3.10 Automjetet:**

- A. Transporti i bombulave te oksigjenit mjekesor i kompresuar, duhet te behet me automjete te pajisura me:
1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
  2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
  3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

*Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë dokumentacionin perkates per kriteret 2.3.9 dhe 2.3.10. (sipas shtojcës 8)*

### **Argumentimi:**

Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

### **Shënim për operatorët ekonomik:**

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve\ ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**



## II. Argumentimi i specifikimeve teknike dhe grafiku i levrimit

Specifikimi i Materialeve:

| Nr | Artikulli | Specifikime teknike                           | Njësia | Planifikimi per 12 muaj |
|----|-----------|-----------------------------------------------|--------|-------------------------|
| 1  | OKSIGJEN  | Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100% | liter  | 65,800                  |

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontroleve periodike te Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ organet kompetente per regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, sipas percaktimeve ligjore.

Ambalazhimi i oksigjenit për përdorim mjeksor të jetë në bombulat e shitësit dhe bombulat të kenë shenjën dalluese “ për përdorim spitalor” (O 2 )

Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me :

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.
4. Transportimi dhe sharkimi i mallit eshte pergjegjesi e shitesit

Furnizimi behet sipas kerkesave dhe nevojave faktike te Autoriteti Kontraktore per kete artikull, bazuar ne kontratat e lidhura gjate gjithë periudhes se vlefshmerise se Marrveshjes Kuader.

Furnizimi do behet me bombola 40 ose 50 litra, me presion sipas kerkesave te AK.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të oksigjenit detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

**Afati i levrimit do te jete brenda 12 muajve, sipas kerkeses se AK, Spitalit Rajonal Diber.**

**Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e levrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e levrimit të mallit.

Furnizimi do te bëhet sipas nevojave dhe kerkesave te SRD (te pakten nje here ne muaj). Njoftimet lidhur me kerkesat per furnizim, duhet te behen ne adresen e emailit te OE te kontraktuar ose ne numrin e telefonit qe do te percaktohet si pike kontakti. Njoftimi duhet bere 2 dite pune para, pa perfshire ditet e pushimit zyrtar por me kushtin qe ne rast emergjence OE duhet te furnizojë AK brenda 24 oreve nga njoftimi.

### Argumentimi:

Specifikimet teknike të mësipërme plotësojnë kushtin për mallera cilësore dhe janë përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/b të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 2, të të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”

(i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 19.08.2024, ora 12<sup>00</sup>**, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**